



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 07.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Matrix IM Shpk" për aktivitetin: "**Furnizimi dhe montimi i kamerave ne institucionet arsimore**" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-087-121** nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Matrix IM shpk" e datës 03.09.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizimi dhe montimi i kamerave ne institucionet arsimore**" me Nr. 616 20 2907 121, me Nr. Brendshëm: 616 -20-087-121.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj tutje me *kete aktivitet*.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Matrix IM Shpk" me datë 03.09.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Furnizimi dhe montimi i kamerave ne institucionet arsimore**" me numër të prokurimit Nr. 616 20 2907 121 dhe numër të brendshëm 616 20 087 121.

Autoriteti Kontraktues, me datë 07.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE Matrix IM lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizimi dhe montimi I kamerave ne institucionet arsimore me nr. të prokurimit: 616-20-2907-1-2-1

Arsyetim:

OE ankues Matrix sh.p.k. nuk ka paraqitur argumente të detajishme se specifikimet teknike I referohen një prodhuesi të caktuar siç ka cekur OE në ankese- brenditë DAHUA. Autoriteti kontraktues në specifikat e publikuara askund nuk ka përdorur brende direkt në mënyrë që të favorizojë një OE/distributor të caktuar dhe përderisa OE ankues nuk ofron fakte se cila prej specifikimeve teknike është favorizuese për një OE të caktuar dhe diskriminuese për OE tjerë, kjo ankese nuk mund të shqyrtohet pasi që nuk ka baze për shqyrtim nuk janë paraqitur argumente të detajishme.

Nder të tjera OE ankues ka parashtruar ankese/kërkesë për ri-shqyrtim jo të rregullt pasi që nuk ka plotësuar pikën 2, 4, 5, 8 të ankesës si dhe pika 3 e ankesës nuk përmban të dhëna të sakta si në kërkesë.

Po ashtu OE ankues në pikën 6 ka cekur nenet e LPP-se- 2, 3, 10, 11, 18.9, 20.4 të cilat nuk kanë të bëjë me deklaratën detale mbi faktet dhe argumentet e paraqitura nga OE ankues, citoj:
Neni 2

Fushëveprimi- tregon lidhur me aplikimin dhe fushëveprimin e ligjit për prokurim publik
Neni 3-

Përfshirjet- tregon për formën e zbatimit të aktiviteteve të prokurimit dhe përfshirjet e prokurimeve të cilat mund të zbatohen/implementime pa u zhvilluar procedurë e prokurimit.
Neni 10

Mjetet për promovimin e Transparencës- vet fakti se procedura e prokurimit zbatohet nëpërmjet e-prokurimit transparenca është maksimale, të gjitha dokumentet e dosjes janë të publikuara në e-prokurim dhe ky nen nuk ka ndërlidhje me argumentet e cekura nga OE ankues pasi që ky nen ka zbatim me shume pas hapjes së ofertave se sa ofrohet transparencë, qasje në dokumente zyrtare etj.

Neni 11

Informatat Sekrete Afariste- Po ashtu neni 11 I cili ka ndërlidhje me nenin 10 nuk ka zbatim në këtë fazë të aktivitetit të prokurimit, të gjitha dokumentet e dosjes janë të publikuara në e-prokurim dhe ky nen nuk ka ndërlidhje me argumentet e cekura nga OE ankues pasi që ky nen ka zbatim pas hapjes së ofertave përkatësisht klasifikimi I informative sekrete afariste do të bëhet pas pranimit të ofertave në rast se OE plotësojnë kërkesën për tu mbajtur ndonjë prej dokumenteve si sekret afarist.

Ndërsa neni 18.9 dhe neni 20.4 nuk ekzistojnë fare, nuk e di ku është bazuar OE ankues kur ka cekur dispozitat ligjore të lartcekura, neni 18 ka gjithsejtë 5 pika d.m.th nuk ekziston 18.9 dhe neni 20 ka 3 pika d.m.th nuk ekziston neni 20.4

Duke marrë parasysh faktet e lartcekura kjo ankese nuk mund të shqyrtohet pasi që është e pabazuar nga vete OE ankues, dispozitat ligjore të cilat janë cekur nuk kanë të bëjë me atë që pretendon OE në pikën 7 të ankesës.

OE ankues nuk ka paraqitur asnjë detaj/argument se AK ka favorizuar ndonjë operator ekonomik apo diskriminuar OE tjerë, në asnjë pjesë të specifikimeve teknike nuk janë përdorur terme që i referohen një brendi të caktuar dhe nuk mund ta plotësojnë prodhues të tjerë.

AK ka respektuar nenin 28- Specifikimet teknike gjatë përpilimit të dosjes për projektin e lartcekur.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit